

Pershendetje Miq te nderuar,

Mire se keni ardhur, ne kete ceremony per te nderuar nje njeri te jashtezakonshem, Me shqiptarin e francezeve, me fisnikun e biznesmenëve, me barmirsin! Mikun tim të shtrenjtë, Z. Julien Roche.

Kam vendosur t'i arkordoj Kordonin e Madh të Urdhrit Mbretëror të Skënderbeut – gradën më të lartë të këtij Urdhri – për arritjet e tij të jashtezakonshme në fushën e sipërmarrjes, përforcimin e miqësisë mes kombit shqiptar dhe francez, për promovimin e parreshtur të vlerave, traditave, potencialit, artit dhe cultures sonë, si edhe për miqësinë dhe besnikërinë e tij ndaj Familjes Mbretërore, kujtimin të mbretit Zog dhe Mbretëreshes Geraldine nepermjet botimeve si edhe kontributit në realizimin e dokumentarit kushtuar Mbretëreshes nga Frederik Miterran I cili do të shfaqet në fillim të janarit në France, Gjermani dhe Shqipëri. Falemnderit që po hidhni dritë në një epokë shumë të rëndësishme të historisë që për shumë kohe është mbajtur në errësire dhe hedhur balte. Fale kontributit tuaj dhe Elia arriem të realizojmë dasmen mbretërore duke promovuar vendin tonë.

Ende nuk kasha lindur kur ju Julien, në vitin 1981, vendoset të ndërmerrni aventurën më të çmendur të jetës suaj: të bëni tregti me vendin më të izoluar në botë.

Ju e keni parë vendin tim shumë here në dëshpërim dhe në mungesë shprese. Megjithatë, keni ruajtur respektin dhe besimin ndaj vendit tim. Shqiptarët do të jenë përherë mirënjohës, sic ata dinë të jenë ndaj çdo miku që l'a respekton atdheun.

Në kohëra shumë të vështira ju keni qene besnik I Shqipërisë dhe I jeni dedikuar asaj.

Më 21 maj 2013, Presidenti I Republikës ju ka dhene nënshtetësinë shqiptare, po ju keni qene Shqiptar në zemer që në fillimet e këtij udhëtimi.

Duke ju vendosur shenjat e Kordonit të Madh të Urdhërit të Skënderbeut, kam bindjen më të thellë se historia do të jetë dëshmitare që sot po nderojmë një mik të çmuar, jo vetëm të Familjes Mbretërore, por të mbarë Kombit tonë. Uroj që të gjithë Shqiptarët ta duan këtë vend ashtu sic e keni dashur ju.

Tani do të vazhdojmë me leximin e dekretit të akordimit të Kordonit të Madh të Urdhërit të Skënderbeut.